



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 17 mars 2011
Nr. ref.: RK99/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në rastet

KI 29/09, KI 32/09 dhe KI 47/09

Parashtruesit

Teki Bokshi, Avdi Rizvanolli dhe Qaush Smajlaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr.
2003/13, të ndryshuar dhe zëvendësuar**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Teki Bokshi, z. Avdi Rizvanolli, avokatë nga Gjakova, dhe z. Qaush Smajlaj, nga fshati Dujakë, që përfaqësohet nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Urdhëresa Administrative e kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Urdhëresën Administrative të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) Nr. 2003/13, të ndryshuar dhe zëvendësuar me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6, që hyri në fuqi më 11 qershor 2003.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës pohojnë që përdorimi i neneve 22.7 dhe 64.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13 dhe i neneve 22 (7) dhe 25 (1) (b) të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2006/17, që e zëvendësoi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13, të 6 dhjetorit 2006, janë në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Parashtruesit e kërkesës më tej pohojnë se janë shkelur neni 6 dhe neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 6 i Konventës i referohet të drejtës për proces të rregullt dhe neni 14 i referohet ndalimit të diskriminimit.

Baza juridike

4. Nenet 113.1 dhe 7 të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenet 46 dhe 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe neni 69 dhe neni 54 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesit e kërkesës i parashtruan kërkesat e tyre në Gjykatë ndërmjet prillit dhe tetorit 2010, me të cilat e kontestonin kushtetutshmërinë e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13.
6. Më 17 mars 2010, Kryetari nxori Vendimin Nr. Ur. 47-09-bk/10 për t'i bashkuar kërkesat KI 19/10, KI 29/09, KI 32/09 dhe KI 47/09.
7. Më 17 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për pranueshmëri vetëm për kërkesat Nos. KI 29/09, KI 32/09 dhe KI 47/09.
8. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi që për kërkesën KI 19/10 të vendosej veçmas.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesit e kërkesës pohojnë që nenet 22 (7) dhe 64 (7) i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13, të ndryshuar dhe zëvendësuar, janë “në kundërshtim me nenet 5, 23, 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës” dhe “në kundërshtim me rregullin e përcaktuar me nenin 6 – e drejta për proces të rregullt, dhe posaçërisht me nenin 14 – ndalimin e diskriminimit, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.
10. Parashtruesit e kërkesës i mbështesin kërkesat e tyre vetëm duke iu referuar dokumenteve të cituara në kërkesën e parashtruar në Gjykatë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesit e kërkesës pohojnë që nenet 22.7 dhe 64.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13, e ndryshuar dhe zëvendësuar, është në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Në veçanti, parashtruesit e kërkesës theksojnë se janë shkelur dispozitat e nenit 5 (Gjuhët), nenit 23 (Dinjiteti i Njeriut), nenit 24 (Barazia para Ligjit), dhe nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës.
12. Neni 22.7 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13 u ndryshua dhe zëvendësua fillimisht me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2006/17 dhe së fundi me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6.
13. Neni i kontestuar i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut është neni i tanishëm 25.7; ai parashikon gjuhën në të cilën rastet duhet të dorëzohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe thotë me sa vijon:

25.7 Parashtresat dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Por, nëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, duhet të sigurohet edhe përkthimi i të gjitha parashtresave dhe dokumenteve përcjellëse edhe në gjuhën angleze. Shpenzimet e përkthimit i heq pala.

14. Neni 64.7 i Urdhëresës origjinale Administrative të UNMIK-ut tani është zëvendësuar me nenin 67.11 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6; ai parashikon përkthimin e dokumenteve lidhur me kërkesëpaditë e ushtruara kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe thotë me sa vijon:

67.11 Dhoma e Posaçme, kur është e nevojshme, përkujdeset për përkthimin e ankesës në gjuhën angleze, të ndonjë parashtrese tjetër dhe të çdo dokumenti përcjellës. Këto përkthime duhet t'i dërgohen ankuesit(ve) dhe Agjencisë menjëherë pasi të jenë përkthyer, që do të thotë jo më vonë se shtatë ditë para seancës gojore.

15. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se sipas Urdhëresës Administrative, në disa kërkesëpadi të ushtruara kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, Dhoma e Posaçme do t'i përkthejë në gjuhën angleze parashtresat që bëhen nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe prandaj kjo paraqet diskriminim.
16. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se është shkelur neni 6 dhe 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë të kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
18. Neni 113.7 i Kushtetutës thotë: "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë". Megjithatë, parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar se janë viktimë e shkeljes së të drejtave nga ndonjë autoritet publik.

19. Për më tepër, neni 47.1 i Ligjit thotë: *“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.*
20. Megjithatë, parashtruesit e kërkesës përsëri nuk dëshmojnë se të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur ose shkelen drejtpërdrejt nga ndonjë autoritet publik. Neni 69 i Rregullores së punës thotë: *“Kur parashtrohet kërkesa sipas nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të paraqes në mënyrë bindëse se të drejtat dhe liritë e tij/ saj të garantuara me Kushtetutë janë shkelur drejtpërdrejt dhe aktualisht”.*
21. Së fundi, neni 53 i Kushtetutës thotë: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
22. Sipas praktikës gjyqësore të Strasburgut, sistemi i peticioneve individuale...nuk lejon parashtrimin e kërkesave përmes *actio popularis*. Prandaj, ankesat duhet të parashtrohen personalisht, ose në emër të personave të cilët pohojnë se janë viktimë e shkeljes së një ose më shumë dispozitave të Konventës. Personat e tillë duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë që ishin “prekur drejtpërdrejt” nga masat ndaj të cilave ankohen (shih p.sh., Aktgjykimin në rastin *İlhan kundër Turqisë*, Nr. 22277/93, 27 qershor 2000, paragrafi 52).
23. Pasi parashtruesit e kërkesës, si parashtrues individualë të kërkesave, nuk kanë dëshmuar se janë palë e autorizuar, kërkesat duhet të hidhen poshtë si të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe Rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri,

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim në fuqi menjëherë.

Gjyqta i Rapo tues

Mr. Sc. Kadri Kryezin

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani